



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Monitorimi i prokurimit publik në ndërmarrjet publike: Prishtina Parking, Trafiku Urban, Kuzhina Qendrore dhe KRU Prishtina

Prill
2023





QEVERISJE E MIRË

AUTORË:

Ardit Dragusha
Egzona Kozhani



Vizitoni ueb faqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@DemocracyPlus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyret tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Deklarata mohuese: Ky raport është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti “Qeverisje e mirë: prokurim publik dhe politik-bërje e avancuar” i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).

Përmbajtja

Hyrje	6
Metodologjia	7
Prishtina Parking - Furnizimi me paisje teknologjike	8
Trafiku Urban - Servisimi i aparateve kundër zjarrit	12
Kuzhina Qendrore - Furnizimi dhe montimi i paneleve solare	15
KRU Prishtina - Furnizimi me klor gazët dhe hipoklorur natriumi	17
Të gjeturat	20
Rekomandime	21

Lista e Shkurtesave

AK ➤ Autoriteti Kontraktues

DT ➤ Dosja e Tenderit

KRPP ➤ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

KRU ➤ Kompania Rajonale e Ujësjetësimit

LPP ➤ Ligji për Prokurimin Publik

NP ➤ Ndërmarrje Publike

NPL ➤ Ndërmarrja Publike Lokale

OE ➤ Operatori Ekonomik

OSHP ➤ Organi Shqyrtues i Prokurimit

PC ➤ Kompjuter Personal

Hyrje

Në Kosovë ekzistojnë një numër i madh i ndërmarrjeve publike të nivelit qendror, rajonal dhe lokal të cilat mbulojnë fusha shumë të rëndësishme si furnizimi me ujë, me energji elektrike, me ushqim, transport publik, mbledhje e mbeturinave, organizim të parkingjeve në kryeqytet, etj.

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) vlen për të gjitha aktivitetet e prokurimit dhe për të gjitha institucionet publike (apo organizatat buxhetore), duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike. Gjatë viteve, Demokraci Plus (D+) ka bërë monitorimin e aktiviteteve të prokurimit të komunave dhe ministrive të ndryshme, ndërsa këtë vit, monitorimi i prokurimit publik është i fokusuar në ndërmarrjet publike të nivelit lokal dhe rajonal.

Ky raport i shkurtër përfshinë katër tenderë të katër ndërmarrjeve të ndryshme publike. Tenderi i parë ka të bëjë me furnizim me pajisje teknologjike të N.P.L. Prishtina Parking; tenderi i dytë ka të bëjë me servisim të aparateve për fikjen e zjarrit të N.P.L. të Trafiku Urban; tenderi i tretë ka të bëjë me furnizim dhe montim të paneleve solare të N.P.L. Kuzhina Qendrore; ndërsa tenderi i katërt ka të bëjë me furnizim me klor të gazët dhe hipoklorur natriumi të Kompania Rajonale e Ujësjetësimit – Prishtina.

Metodologjia

Hapi i parë për realizimin e këtij raporti ka qenë hulumtimi në platformën elektronike e-prokurimi, përmes së cilës është bërë hulumtimi fillestar dhe zgjedhja tenderëve. Hulumtimi është fokusuar në tenderë për të cilët procedurat e tenderimit janë zhvilluar nga muaji janar deri në mars të vitit 2023.

Më qëllim të kompletimit të dokumenteve të nevojshme për hulumtim, D+ ka dërguar kërkesat për qasje në dokumente publike në ndërmarrjet e përzgjedhura, duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe mbledhjen e dokumenteve të nevojshme për monitorim.

Raporti është finalizuar me analizimin e këtyre dokumenteve, ndërsa për nevoja të procesit të monitorimit, D+ ka zhvilluar një vizitë në ndërmarrjen publike “Trafiku Urban” për t’i parë nga afër disa nga aparatet e servisuara.

Prishtina Parking

Furnizimi me pajisje teknologjike

Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking (tutje autoriteti kontraktues – AK), në janar të vitit 2023 ka nënshkruar kontratën kornizë me kohëzgjatje prej 36 muajsh për furnizim me pajisje teknologjike. Vlera e parashikuar e këtij aktiviteti është caktuar të jetë 10,050.00 euro, ndërsa kontrata është lidhur në vlerë prej 8,967.00 euro në mes kësaj ndërmarrje dhe operatorit ekonomik (OE) Infinitt Sh.P.K. Në këtë tender kanë ofertuar vetëm dy operatorë ekonomikë edhe pse ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur.

TABELA 1. Ofertat e operatorëve ekonomikë

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertave
1	Trio Tek Sh.P.K.	9,779.00 euro
2	Infinitt Sh.P.K.	8,967.00 euro

Sipas kushteve të veçanta të kontratës, dërgesa e pajisjeve do të bëhej brenda dhjetë ditëve pas pranimit të urdhërblërjes nga ana e furnizuesit. Prishtina Parking përmes kësaj kontrate do të blinte 12 kompjuterë personal, 12 monitorë dhe 11 hard-diska të jashtëm. Për këto pajisje teknologjike janë caktuar specifika të cilat furnitori duhet tu përmbahet në mënyrë që të përmbushet kontrata (shih tabelën në vazhdim).

TABELA 2. Paramasa e paplotësuar me përshkrimin e specifikave teknike të pajisjeve teknologjike

Furnizim me pajisje teknologjike						
Nr.	Përshkrimi i mallit	Specifikat	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi Total
1	Kompjuter personal	Intel Core i5 -10105, 8gb ddr, 480 gb SSD + 1 TV HDD, Keyboard dhe mouse	Copë	12		
2	Monitor	24 Wide VA24DQ, Eye Care Monitor 23.8 Full HD	Copë	12		
3	Hardisk i jashtëm	1 TB	Copë	11		
					Total me TVSh	

Sipas tabelës 2, në pozicionin e parë janë kërkuar 12 kompjuterë personal. Specifikat të cilat janë përcaktuar e bëjnë të pamundur këtë furnizim, pasi që nuk ekziston kompjuter me këto specifika. Më saktësisht Intel Core i5 – 10105 nuk ekziston, ngase Intel nuk ka prodhuar procesor i5 me shifrën 10105, por me këto specifika ka procesor vetëm i3. Kjo mund të vërtetohet edhe nga faqja zyrtare e kompanisë Intel në të cilën shohim emrat dhe specifikat e produkteve të tyre. Sipas kësaj, procesorët i3 kanë shifra të ndryshme identifikuese si 10105, 10105F, 10105T,

10305, 10305T, 10325, 10100Y, 10100F, 10200, 10100E, etj¹. Ndërsa, në listën e procesorëve i5 ka shifra identifikuese si 10505, 10500H, 10200H, 10310U, 1038NG7, 10400, 10400F, etj², por që askund në këtë listë nuk mund të gjendet se kjo kompani prodhon procesor i5 me shifrën 10105. Kjo nënkupton se një furnizim me specifikat e kërkuara, potencialisht ka pamundësuar ofertimin e shumë kompanive tjera. Ky problem është vërejtur edhe nga kompanitë që kanë pasur interesim të aplikojnë në këtë tender. Një OE ka kërkuar sqarime lidhur me këtë pozicion në paramasë, duke aluduar se ka mundur të ndodhë ndonjë gabim në specifikat e këtij pozicioni, i cili ka thënë se Intel Core i5 gjendet në treg, por nuk e ka specifikuar shifrën identifikuese 10105. Mirëpo, AK nuk ka pranuar kërkesën dhe ka theksuar se specifikimet teknike janë të detyrueshme dhe mbesin të pandryshuara. Për më shumë, AK ka shtuar se specifikat më të avancuara në procesor si i7, i9 janë të pranueshme.

Ky sqarim në këtë pikë bije në kundërshtim me dosjen e tenderit, ku në fletën e të dhënave të tenderit thuhet se nuk autorizohen variantet, që do të thotë se nuk do duhej lejuar dërgimi i kompjuterëve personal me procesor tjetër. Përveç se ky lejim është kontradiktor me atë se çfarë ka përcaktuar AK në dosje të tenderit, ai po ashtu është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), sepse AK duhet të shënoj në dosje të tenderit nëse autorizohen variante apo jo, në të kundërtën nuk do të autorizohen variantet pa këtë indikacion³. Po ashtu, AK-ve ju mundësohet autorizimi i varianteve nëse kontrata do t'i shpërblehet tenderuesit ekonomikisht më të favorshëm⁴, ndërsa në dosje të tenderit është potencuar se kriteri për dhënie të këtij tenderi është çmimi më i ulët. Lidhur me këtë çështje, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) ka dhënë një opinion në të cilin sqaron se "Kurdo që AK lejon variantet, duhet të përdorë kriterin ekonomikisht më të favorshëm dhe të përcaktoj qartë nën-kriteret që lejojnë një vlerësim të drejtë, të barabartë, transparent dhe jo diskriminues të ofertuesve"⁵.

Edhe pse në këtë situatë nuk janë lejuar variacionet, del se as procesorët i7 e i9 të mos kenë shifër identifikuese 10105. Procesori i7 në data bazë të prodhuesit ka shifrat si: 10870H, 10610U, 10810U, 1068NG7, 10700, 10700E, etj.⁶ ku askund nuk mund të gjendet shifra e kërkuar nga AK. E njëjta situatë është edhe me procesorin i9 për të cilin nuk ka asnjë shifër 10105, por disa nga shifrat janë 10850K, 10885H, 10900, 10900E, 10900F, 10900K, etj⁷.

Pra, me specifikat e tilla të caktuara del se AK ka kërkuar produkt i cili nuk ekziston dhe rrjedhimisht as operatori ekonomik fitues nuk ka mundësi të ketë bërë furnizimin sipas këtyre kërkesave. Me këto specifika, AK ka shkëlur një nga parimet themelore të prokurimit publik i cili është jo-diskriminimi, ku gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, AK-të duhet të sigurojnë pjesëmarrje sa më të gjerë të mundshme të operatorëve ekonomikë të interesuar dhe në asnjë aspekt AK nuk do të ekzekutoj një aktivitet të prokurimit në atë mënyrë që ky aktivitet të reduktoj apo eliminoj konkurrencën⁸. Kjo edhe duhet të jetë arsyeja pse për këtë tender kanë ofertuar vetëm dy kompani, kurse mesatarja e ofertave për të njëjtat lëndë të prokurimit në vitin 2022 ka qenë katër oferta.

1 10th Generation Intel Core i3 Processors, Intel. <https://ark.intel.com/content/www/us/en/ark/products/series/195733/10th-generation-intel-core-i3-processors.html> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

2 10th Generation Intel Core i5 Processors, Intel. [10th Generation Intel® Core™ i5 Processors Product Specifications](https://ark.intel.com/content/www/us/en/ark/products/series/195733/10th-generation-intel-core-i5-processors.html) (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

3 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 29.2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

4 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 29.1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

5 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Opinione, pika 9, 22.11.2022. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=545> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

6 10th Generation Intel Core i7 Processors, Intel. [10th Generation Intel® Core™ i7 Processors Product Specifications](https://ark.intel.com/content/www/us/en/ark/products/series/195733/10th-generation-intel-core-i7-processors.html) (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

7 10th Generation Intel Core i9 Processors, Intel. [10th Generation Intel® Core™ i9 Processors Product Specifications](https://ark.intel.com/content/www/us/en/ark/products/series/195733/10th-generation-intel-core-i9-processors.html) (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 7 pika 2 dhe 6. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

Në bazë të përgjigjeve nga AK, operatori ekonomik fitues ka dorëzuar kompjuter personal me specifikat Intel Core i5 – 10400 dhe 465 gb⁹. Kjo nënkupton se pajisjet janë pranuar nga AK në kundërshtim me kërkesat specifike pavarësisht se të njëjtat janë të detyrueshme. Në katalogun e dorëzuar nga OE fitues¹⁰, thuhet se do të dorëzohet kompjuter i gjeneratës së 11, ndërsa realisht furnizimi është bërë me kompjuter të gjeneratës së dhjetë. Specifikat teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm¹¹. Rrjedhimisht, AK ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik të papërgjegjshëm.

Operatori ekonomik fitues, për këtë kërkesë ka furnizuar autoritetin kontraktues me kompjuter personal të markës Leksus, ku për një kompjuter personal të tillë së bashku me tastierë dhe mi (mouse) ka vendosur çmimin prej 535.00 euro, apo që në total për këtë pozicion është vendosur çmimi prej 6,420.00 euro për 12 kompjuter të tillë.

Kompjuterët personal të markës Leksus nuk gjinden në ndonjë platformë ekzistuese të specializuar në shitjen e pajisjeve të tilla elektronike. Madje, as në platformën Google kompjuter personal të markës Leksus nuk gjinden. E njëjta situatë ka rezultuar edhe nga hulumtimi në terren, ku në asnjë prej dyqaneve që mbajnë pajisje të tilla nuk është gjendur kompjuter personal i markës Leksus. Në këtë rast, meqenëse AK planifikon të shpenzoj rreth 9 mijë euro për blerjen e pajisjeve të tilla, duhet të siguroj se po merr pajisje të besueshme dhe të jetë në gjendje që për atë pajisje të hulumtoj tregun në mënyrë që të dijë nëse po merr pajisjen me çmimin e tregut. Por, për një produkt të tillë është problem të vlerësohet çmimi i tregut pasi që i njëjti është problem të gjendet në treg.

TABELA 3. Paramasa e plotësuar nga OE fitues me përshkrimin e specifikave teknike të pajisjeve teknologjike

Furnizim me pajisje teknologjike						
Nr.	Përshkrimi i mallit	Specifikat	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi Total
1	Kompjuter personal	Intel Core i5 -10105, 8gb ddr, 480 gb SSD + 1 TV HDD, Keyboard dhe mouse	Copë	12	535.00	6,420.00
2	Monitor	24 Wide VA24DQ, Eye Care Monitor 23.8 Full HD	Copë	12	160.00	1,920.00
3	Hardisk i jashtëm	1 TB	Copë	11	57.00	627.00
					Total me TVSh	8,967.00

Specifikat për këta kompjuter personal, OE i ka përshkruar në broshurë në të cilën përmendet vetëm "PC Intel Core i5 Leksus – gen 11, 8gb RAM ddr, 480 gb SSD + 1 TV HDD" duke mos e përmendur askund shifrën 10105. Mos specifikimi i kësaj shifre nënkupton se OE nuk i është përmbajtur kërkesës në fjalë.

⁹ Informata të marra nga autoriteti kontraktues N.P.L. Prishtina Parking, me datë 14.03.2023 pas pyetjeve shtesë. Kërkesa për qasje në dokumente publike është dërguar me datë 23.02.2023.

¹⁰ Dokumentacioni i marrë pas kërkesës në qasje në dokumente publike të dërguar me datë 23.02.2023.

¹¹ Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 19.11. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

Situatë deri diku e ngjashme është edhe me pozicionin e dytë. Me një kërkim të thjeshtë në platformën Google vërehet se specifikat e tilla të dërgojnë te monitori i një prodhuesi specifik ngase shifra VA24DQ është unike vetëm për monitorin e prodhuesit ASUS¹². Në këtë situatë, AK nuk ka marrë parasysh një element shumë të rëndësishëm se specifikat teknike duhet të përpilohen në atë mënyrë që të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar për të ofertuar në një aktivitet të caktuar të prokurimit. AK është veçanërisht i ndaluar që të hartoj specifika teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë¹³. Po ashtu, AK nuk duhet të përpilojë specifikime teknike që i referohen ndonjë prodhimi, lloji apo origjine të veçantë¹⁴. Autoriteti kontraktues me hartimin e këtyre specifikave ka shkelur LPP-në i cili përcakton me saktësi se si duhet të hartohen specifikimet teknike, po ashtu edhe se në cilat raste duhet të lejohen variantet dhe si të përdoren ato.

Deri më tani, AK ka porositur vetëm gjashtë kompjuterë personal, gjashtë monitorë dhe gjashtë hard-disqe të jashtme, me total faturë prej 4,512.00 euro dhe mbetet të realizohen furnizime në vlerë prej 4,455.00 euro.

12 ASUS VA24DQ Eye Care Monitor. <https://www.asus.com/displays-desktops/monitors/eye-care/va24dq/> (qasur për herë të fundit me 29.03..2023).

13 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 28.2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

14 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 28.7. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

Trafiku Urban

Servisimi i aparateve kundër zjarrit

Ndërmarrja publike “Trafiku Urban” (tutje autoriteti kontraktues – AK) ka iniciuar procedurë të tenderimit me vlerë minimale për servisimin e aparateve kundër zjarrit. Sipas kërkesës, servisimi i këtyre aparateve duhet të bëhet çdo gjashtë muaj¹⁵. Me këtë kontratë parashihet të bëhen dy servise brenda vitit 2023, një me datë 07.01.2023 dhe tjetri me datë 07.07.2023. Përmes kësaj kontrate do të servisohen pesë artikuj të ndryshëm, në total prej 104 aparateve.

Kjo kontratë është lidhur në mes të AK dhe operatorit ekonomik të suksesshëm në vlerë prej 962.00 euro.

TABELA 3. Aparatet që duhet të servisohen nga ky tender dhe çmimet e vendosura nga operatori ekonomik fitues

Artikujt	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€ (duke përfshirë të gjitha taksat etj)*	Çmimi Total - €
1	P6 për autobusë	copë	52	10.00 euro	520.00 euro
2	C10 për objekt	copë	13	8.00 euro	104.00 euro
3	C5 për objekt	copë	13	8.00 euro	104.00 euro
4	P9 për objekt	copë	13	8.00 euro	104.00 euro
5	P6 për objekt	copë	13	10.00 euro	130.00 euro
Totali i Përgjithshëm					962.00 euro

*Këto çmime janë të vendosura për dy servisimet, që i bije se për herën e parë të servisimit do të paguhet gjysma e çmimit, ndërsa gjysma tjetër në servisimin e radhës.

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar tre operatorë ekonomikë, ndërsa me kontratë është shpërblyer operatori ekonomik Albkos Safety Sh.P.K.

15 Udhëzim Administrativ (MPB) nr. 17/2017 për Testim dhe Servisimin e Aparateve për Fikjet e Zjarrit, neni 9.2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15810> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

TABELA 5. Ofertat e operatorëve ekonomikë fitues

Nr.	Operatorët ekonomikë ofertues	Vlera e ofertave
1	L&G Sh.P.K.	994.50 euro
2	Albkos Safety Sh.P.K.	962.00 euro
3	N.P.Sh. Emergjenca	945.00 euro

Në mesin e këtyre tri ofertave, oferta më e lirë ishte e N.P.Sh. Emergjenca në vlerë prej 945.00 euro, mirëpo kjo kompani ishte diskualifikuar nga kjo procedurë. Sipas njoftimit për vendim të AK-së, ky OE u diskualifikua ngase nuk ka plotësuar saktë formularin e çmimit dhe deklaratën nën betim. Vlerësimi se deklarata nën betim nuk është plotësuar saktë ka qenë gabim¹⁶, pra del se ky operator nuk ka gabuar në këtë dokument. Sa i përket mos plotësimit të saktë të formularit të çmimit, OE ofertues në formularin për dorëzim të tenderit ka plotësuar çmimin 945.00 euro, ndërsa në paramasë ka vendosur çmimin 994.50 euro. Për refuzimin e këtij operatori AK ka vepruar drejt, ngase nëse këta formularë nuk plotësohen si duhet, tenderi refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme¹⁷.

Por, në shërbimin e parë janë servisuar 106 pajisje për fikjen e zjarrit pavarësisht se në paramasë janë përshkruar të jenë 104 pajisje të tilla, ndërsa vlera që është paguar është 436.00 euro. Nga kjo del se nuk është shpenzuar gjysma e çmimit total për këtë shpenzim. Fatura e parë do të duhej të ishte 481 euro, apo 45 euro më shumë.

TABELA 6. Fatura e parë me çmimet dhe artikujt/shërbimet e ofruara nga OE fitues

Nr.	Nr. i artikullit	Përshkrimi i artikullit/shërbimit	Sasia	Çmimi/pa TVSh	TVSh (%)	Çmimi me TVSh*	Gjithsej pa TVSh	
1	SAKZCO2-5KG	Servisimi i AKZ 5 kg – CO2 (SH)	12 copë	4.24 euro	18	5 euro	50.85 euro	
2	SAKZCO2-10KG	Servisimi i AKZ 10 kg – CO2 (SH)	13 copë	3.39 euro	18	4 euro	44.07 euro	
3	SAKZ6KG	Servisimi i AKZ 6 kg – pluhur (SH)	70 copë	3.39 euro	18	4 euro	237.29 euro	
4	SAKZ9KG	Servisimi i AKZ 9 kg – pluhur (SH)	11 copë	3.39 euro	18	4 euro	37.29 euro	
							Gjithsej pa TVSh	369.49
							Gjithsej TVSh	66.51
							Gjithsej me TVSh	436.00
							Pagesa	0.00
							Mbetur për pagesë	436.00

*çmimet e vendosura me TVSh janë llogaritur nga autori i raportit për t'i shërbyer këtij raporti dhe të njëjtat nuk kanë qenë të përfshira në faturën origjinale.

¹⁶ Takimi i mbajtur me zyrën e prokurimit në datën 15.03.2022.

¹⁷ Udhëzues nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, pika 10. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

Në mes të kësaj fature dhe paramasës së plotësuar nga OE fitues, ka mospërputhje. Kjo mospërputhje vërehet te sasi të shërbimit dhe te çmimi i shërbimit. Në paramasë (tabela 4) janë gjithsej 104 aparate që duhet të servisohen, ndërsa me faturë (tabela 6) është paguar servisimi i 106 aparateve. Ndryshe tregohet në raportin e servisimit të aparateve për shuarjen e zjarrit, ku del se në realitet janë servisuar 100¹⁸ aparate të tilla.

Në faturë aparatet e 6kg që janë servisuar del të jenë 70 copë, ndërsa AK në paramasë nuk ka paraqitur se posedon 70 aparate të kësaj peshe. Sipas AK-së, P6 për autobus dhe P6 për objekt janë ekuivalente me pozicionin e tretë në faturë, pra SAKZ 6KG. Gjithsesi, në paramasë janë përshkruar 52 aparate P6 për autobus dhe 13 aparate P6 për objekt, që i bije se edhe po të jenë bashkuar këto dy pozicione, nuk del të jenë 70 aparate të tilla por 65 aparate për fikjen e zjarrit. Në tenderin për të njëjtin qëllim të iniciuar në vitin 2021, AK ka bërë kërkesën identike, pra 52 aparate P6 për autobusë dhe 13 P6 aparate për objekt, e cila nënkupton se aparate me peshë 6 kg janë vetëm 65 dhe jo 70 copë.

Lidhur me faturën, AK ka dhënë përgjigje vetëm për çmimet ndërsa nuk ka dhënë sqarime se si ka ardhur deri te ndryshimi i sasisë së këtyre aparateve. Në raportin e servisimit të aparateve për shuarjen e zjarrit të bërë nga OE fitues, del të jenë servisuar 51 aparate të peshës 6 kg për autobusë dhe 14 aparate të së njëjtës peshë për objekte. Pra, i bije të jenë servisuar 65 aparate ndërsa janë faturuar 70 aparate, apo janë paguar pesë më shumë. Gabime të tilla kanë ndodhur edhe për aparatet e peshave të tjera, si p.sh. aparati i peshës 9 kg, në paramasë është paraparë servisimi i 13 aparateve të kësaj peshe, kurse janë faturuar 11 copë dhe është paguar për 11 copë. Në raportin për servisim të aparateve janë shënuar se janë servisuar 10 aparate të peshës 9 kg që do të thotë se është paguar për një aparat më shumë.

Në paramasë (tabela 4) çmimi për aparatet 6 kg është paraparë të jetë pesë euro për njërin servisim (10 euro totali për dy serviset). Ndërsa, në faturë aparatet e peshës 6 kg janë faturuar me katër euro. Po ashtu, për pajisjen e peshës 5 kg, në paramasë është paraparë të paguhet 4 euro servisimi i një aparati të kësaj peshe, ndërsa në faturë evidentohet se servisimi për një aparat të tillë është paguar 5 euro. Aparatet e peshës 5 kg është dashur të servisohen 13 copë, ndërsa janë servisuar 12 copë.

Kjo procedurë ka pasur mangësi në planifikim ose problemet janë shfaqur gjatë rrugës, sepse nuk është bërë planifikimi i duhur i nevojave të AK-së ose shërbimi nuk është realizuar sipas kërkesës.

Pavarësisht se lidhur me ngatërresat në pagesa AK thotë se janë gabime teknike¹⁹, të njëjtat nuk kanë ndodhur vetëm të pagesat por edhe te numri i pajisjeve të servisuara. Në pjesën e dytë të vitit 2023 kur do të bëhet servisimi i dytë, AK maksimalisht mund të paguaj 481 euro, pra gjysmën e vlerës së kontratës, gjithmonë nëse i përmbahet planifikimit sipas paramasës, e në fund fare nuk do realizohet çmimi i plotë i kontratës. Prandaj, AK duhet të ketë kujdes të shtuar në përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga zhvillimi i një procedure të tillë. Pavarësisht se dallimi monetar nuk është i lartë, AK nuk mund të lejoj të mos përmbush obligimin ndaj operatorit por dhe anasjelltas. Për më tepër, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me kontratë publike kornizë, ku duhet të përmbushet së paku 70% e kontratës²⁰, pra kjo kontratë duhet të përmbushet plotësisht, por përmbushja e plotë e kontratës do të jetë problematike për autoritetin kontraktues.

Sipas platformës së e-prokurimit del se OE fitues ka 30 kontrata në realizim e sipër, me autoritete të ndryshme kontraktuese, kontrata të cilat kryesisht kanë të bëjnë me furnizim apo servisim të pajisjeve kundër zjarrit. Pjesa e dytë e kësaj kontrate pritet të përmbushet në gjysmën e dytë të vitit 2023, kurse shumica e mbetur nga kjo kontratë është 526.00 euro.

18 Dokument i marrë nga AK me datë 16.03.2023, pas kërkesës për qasje në dokumente publike të bërë më datë 23.03.2023.

19 Takim i mbajtur me datë 15.03.2023.

20 Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 54.11. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

Kuzhina Qendrore

Furnizimi dhe montimi i paneleve solare

Ndërmarrja Publike “Kuzhina Qendrore Sh.A.” (tutje autoriteti kontraktues – AK) në janar të 2023 inicioi tenderin për furnizimin dhe montimin e paneleve solare, në vlerë të parashikuar të kontratës 36,000.00 euro. Ky investim kapital bëhej në bashkëfinancim me Komunën e Prishtinës, ku “Kuzhina Qendrore” merrte pjesë me 5,000.00 euro ndërkohë pjesa tjetër prej ishte investim nga komuna.

“Kuzhina Qendrore” si ndërmarrje publike është themeluar në qershor të 2019²¹, ndërkohë që aktivitetet e prokurimit ende i zhvillon përmes zyrës së prokurimit të Komunës së Prishtinës.

Për këtë tender ofertuan katër operatorë ekonomikë teksa për kontratë u rekomandua Unisolar L.L.C., me ofertë në vlerë 29,499.10 euro si tenderi me çmimin më të ulët. Tre ofertuesit e tjerë u eliminuan si të papërgjegjshëm.

TABELA 7. Operatorët ekonomikë që morën pjesë në tenderin për furnizim dhe montim të paneleve solare

Nr.	Emri i operatorit ekonomik	Vlera totale e ofertave
1.	Unisolar L.L.C	29,499.10 euro
2.	Meps-A	31,339.97 euro
3.	Ra-ta Sh.P.K.	34,821.60 euro
4.	N.T.Sh Elen	35,478.65 euro

Megjithatë, autoriteti kontraktues nuk respektoi si duhet kërkesat e vendosura te Dosja e Tenderit (DT) gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik Unisolar L.L.C., ndonëse i njëjti nuk kishte plotësuar disa kritere.

Fillimisht, në DT te kapacitetet teknike dhe profesionale, kërkohej që operatori ekonomik të prezantonte listën e nënshkruar dhe vulosur të personelit, prej së paku katër personave që do të merrnin pjesë në këtë projekt. Gjithashtu, kërkohej që udhëheqësi i projektit të ishte inxhinier i diplomuar i elektros me të paktën dy vite përvojë punë pas diplomimit.

21 Ndërmarrja Publike “Kuzhina Qendrore” Sh.A. është themeluar me datën 5 qershor 2019, nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Shih më shumë: <https://kuzhina.net/per-ne/> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

Në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, nuk figuron fare lista e nënshkruar dhe vulosur e personelit të angazhuar dhe as vendimi për caktimin e udhëheqësit të projektit. Në fakt, asnjëri nga gjashtë personat e paraqitur si staf profesional nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara për pozitën e udhëheqësit të projektit (diplomë të drejtimit elektro/referenca për dy vite përvojë punë pas diplomimit).

Pastaj, te përshkrimi i çmimeve në paramasë, fuqia nominale fikse e paneleve solare ishte kërkuar të ishte 545 W, ndërkohë që Unisolar L.L.C., ka prezantuar fuqinë e panelit solar 550W.

Në lidhje me dëshmitë mbi kërkesat e pranueshmërisë, Unisolar L.L.C., ka dorëzuar certifikatën nga Gjykata Komerciale në Prishtinë, ku shkruan se është kërkuar me qëllim të pjesëmarrjes në Zgjerim të Kompanisë në Shqipëri, dhe se e njëjta nuk mund të përdoret për qëllime të tjera. Komisioni i vlerësimit ka pranuar këtë dëshmi si të rregullt, ndonëse është dashur të paktën të kërkojë sqarime shtesë nga ky operator ekonomik.

Një shkelje e rregullave të prokurimit është evidentuar edhe në hartimin e paramasës, ku shkruan se operatorët ekonomikë me çmime jo-normalisht të ulëta do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Vendosja e këtij kushti nuk është në diskrecion të autoritetit kontraktues dhe eliminimi automatik mbi bazën e çmimit jo-normalisht të ulët ndalohet me Rregulloren për Prokurimin Publik, konkretisht Neni 41.2²², i cili thotë:

“Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët”.

Vendimi i autoritetit kontraktues për shpërblim me kontratë të Unisolar L.L.C., është apeluar²³ në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) nga N.T.Sh. Elen, për të cilën deri në momentin e përfundimit të këtij raporti nuk ka një vendim përfundimtar nga OSHP.

22 Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

23 Organi Shqyrtues i Prokurimit. Ankesa 93/23 pranuar me 16.02.2023.

KRU Prishtina

Furnizimi me klor gazët dhe hipoklorur natriumi

Në fillim të vitit 2023, Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) "Prishtina" Sh.A., hapi tenderin për furnizim me klor të gazët dhe hipoklorur natriumi në vlerë të parashikuar të kontratës prej 67,600.00 euro.

KRU Prishtina synonte furnizimin e 18,000 kg klor të gazët dhe 10,000 kg hipoklorur natriumi për trajtim të ujit të papërpunuar, si njëri nga proceset kryesore për dezinfektimin e ujit të pijshëm.

Ky tender u zhvillua me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me shpjegimin se për këtë aktivitet të prokurimit kishte pasur dështime të njëpasnjëshme si pasojë e shkëputjes së kontratave dhe ankesave në OShP. Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë mbetet problematik duke qenë se cenon parimin e barazisë në trajtim/jo diskriminimin. Sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) sa i përket përdorimit të procedurës së negociuar:

"Autoriteti kontraktues mund ta përdor procedurën e negociuar për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti kontraktues"²⁴.

Pra, LPP në mënyrë specifike ndalon shfrytëzimin e kësaj procedure nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Arsyetimi i dhënë nga KRU Prishtina²⁵, se përdorimi i kësaj procedure u është imponuar pas dështimeve të aktiviteteve të njëjta të prokurimit si pasojë e shkëputjes së kontratave dhe ankesave në OShP, nuk qëndron për faktin se ky furnizim ka qenë i planifikuar në Planin Vjetor të Prokurimit²⁶ ndërkohë ankesat në OShP nuk paraqesin emergjencë ekstreme. KRU Prishtina për këtë aktivitet të prokurimit ftoi pesë operatorë ekonomikë, nga të cilët vetëm tre dorëzuan oferta.

²⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurimin Publik, Neni 35. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 03.15.2023). (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

²⁵ Njoftimi për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), i bërë me datën 30.01.2023.

²⁶ KRU Prishtina. Planifikimi Final i Prokurimit për vitin 2023. Shih në <https://kru-prishtina.com/rz/planifikime-te-prokurimit/> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

TABELA 8. Operatorët ekonomikë që dorëzuan oferta për këtë aktivitet të prokurimit

Nr.	Operatori ekonomik	Vlera totale e ofertave
1.	Infinitt Sh.P.K.	52,700.00 euro
2.	Seykos Sh.P.K.	66,600.00 euro
3.	Afrim Sadriu B.I	67,307.20 euro

Përveç përdorimit të procedurës së negociuar, autoriteti kontraktues shkurtoi edhe afatin e dorëzimit të ofertave, ku ftesa për ofertim iu dërgua operatorëve ekonomikë me 07.02.2023 ndërkohë afati i fundit për dorëzimin e ofertave sipas dosjes së tenderit ishte me 13.02.2023 në ora 13:00.

Ky shkurtrim i afatit për dorëzimin e ofertave në vetëm gjashtë ditë nuk është në përputhje me LPP-në, që edhe në raste urgjente²⁷ të shkurtimeve të afatit kohor, nuk lejon afat më të shkurtër se 10 ditë për pranimin e ofertave. Pra, afati i cili në këtë rast më i shkurtër se afati minimal ligjor, nuk është i justifikueshëm as në urgjencën e zbatimit të aktivitetit të prokurimit, për faktin se periudha për zbatimin e kontratës sipas dosjes së tenderit është tre muaj.

Për më tepër, as identifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët janë ftuar që të dorëzojnë oferta nuk ka qenë i rregullt sepse janë ftuar operator të cilët nuk punojnë në këtë fushë. Siç e ilustron ftesa e bërë për OE New Corp L.L.C., kjo kompani ka për aktivitet shpërndarjen e lëndëve të para për ndërtimtari, produkte të plastikës dhe produkteve ushqimore dhe e cila asnjëherë nuk ka bërë ndonjë furnizim të natyrës së tillë²⁸. Edhe operatori tjetër ekonomik i ftuar për dorëzim të ofertës, Profitech Sh.P.K., nuk bënë këtë furnizim të klorit të gazët ndaj nuk ka ofertuar fare²⁹.

KRU Prishtina rekomandoi për kontratë ofertën e Seykos Sh.P.K., që kishte vlerë 66,600.00 euro, apo 98.5% e vlerës së parashikuar, si tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve të përgjegjshëm. Ndonëse oferta e operatorit ekonomik Infinitt Sh.P.K., ishte për 13,900.00 euro më e lirë, ajo u eliminua me arsyetimin se nuk kishte dorëzuar kopjen e rregullt të kontratës së punës së vozitësit të licensuar, dëshmi kjo që ishte kërkuar në dosjen e tenderit.

Në ofertën e Infinitt Sh.P.K., figuron kontrata me vozitësin e licensuar i cili është angazhuar për këtë projekt, por neni 4 i kësaj kontrate, i cili thotë se “i punësuari themelon punë, në kohë të caktuar, po aq sa zgjat edhe periudha kontraktuese për një periudhë prej 120 ditë (4 muaj), në rast se ne si OE Infinitt Sh.P.K., arrijmë të nënshkruajmë kontratë për (këtë) projekt” është bërë shkak që e njëjta të diskualifikohet.

Sipas AK-së, kjo kërkesë nuk mund të jetë e kushtëzuar (në qoftë se nënshkruhet kontrata për këtë projekt), dhe si e tillë nuk paraqet kontratë të rregullt të punës, duke bërë që të mos plotësohet kërkesa e përshtatshmërisë profesionale. Vendimi i AK-së për shpërblim me kontratë të Seykos Sh.P.K., është apeluar nga Infinitt Sh.P.K., në OShP duke bërë që ky aktivitet të pezullohet deri në marrjen e një vendimi nga OShP.

27 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurimin Publik. Nenin 46, pika 3. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

28 New Corp L.L.C., Rreth Nesh. <http://www.newcorp-ks.com/rrethnesh.php> (qasur për herë të fundit me 29.03.2023).

29 Drejtuesit e Profitech Sh.P.K., në një bisedë me D+ kanë konfirmuar se nuk bëjnë këtë lloj të furnizimit me klor.

KRU Prishtina dhe Infinitt Sh.P.K., kanë edhe një kontest tjetër në OShP, i cili ka të bëjë me natyrën e njëjtë të furnizimit me klor të gazët, ku autoriteti kontraktues kishte bërë eliminimin e Infinitt Sh.P.K., me arsyetimin se ky operator ekonomik nuk mund të rekomandohet për kontratë për dy vite të ardhshme, pasi që nuk kishte plotësuar një kontratë paraprake.

As për aktivitetin e vitit 2022, OShP nuk ka marrë vendim përfundimtar (deri në publikimin e këtij raporti). Fillimisht ky organ kishte hedhur poshtë ankesën e Infinitt Sh.P.K., si të pasafatshme e pastaj ka vendosur në favor të saj, duke anuluar vendimin e KRU Prishtina.

Të gjeturat

N.P.L. Prishtina Parking:

- N.P.L. Prishtina Parking, në hartimin e specifikave për furnizimin e kërkuar ka vendosur specifika që e pamundësojnë realizimin e furnizimit, pasi që nuk ekziston produkti me ato specifika.
- Në aktivitetin e zhvilluar me procedurë të hapur, N.P.L. Prishtina Parking ka pranuar vetëm dy oferta. Numri i ulët i ofertave potencialisht është rezultat i specifikave të gabuara të hartuara nga kjo ndërmarrje. Në vitin 2022, për të njëjtat lëndë të prokurimit numri i ofertave ka qenë mesatarisht katër oferta për një prokurim të tillë.
- Pavarësisht faktit se specifikat teknike janë të detyrueshme dhe operatori ekonomik fitues duhet tu përmbahet me përpikëri të njëjtave, N.P.L. Prishtina Parking ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik i cili në katalogun e dorëzuar ka treguar se furnizimi nuk i përmbahet specifikave të caktuara nga ndërmarrja në fjalë.
- N.P.L. Prishtina Parking edhe pse në dosje të tenderit nuk i ka lejuar variacionet, në dokumentet për sqarime shtesë ka theksuar se pranon modele më të avancuara, apo variacione. Një veprim i tillë nuk lejohet me Ligjin e Prokurimit Publik.
- N.P.L. Prishtina Parking ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, ku për blerjen e monitorëve ka favorizuar një markë të caktuar, duke vendosur një shifër që të dërgon vetëm te monitori i markës ASUS.

N.P.L. Trafiku Urban:

- N.P.L. Trafiku Urban nuk ka planifikuar saktë numrin e aparateve që do të servisoheshin,

pasi duke u bazuar në faturë del se ka paguar për më shumë aparate se sa që kanë qenë të planifikuar në paramasë.

- N.P.L. Trafiku Urban nuk ka menaxhuar përgjegjshëm ekzekutimin e kontratës për servisimin e aparateve për fikjen e zjarrit, ngase nuk janë servisuar aparatet siç janë paraparë dhe nuk është realizuar pagesa sipas planifikimit.

N.P.L. Kuzhina Qendrore:

- N.P.L. Kuzhina Qendrore ka shpërblyer me kontratë një operator ekonomik i cili nuk i ka përmbushur kërkesat e vendosura në dosje të tenderit.
- N.P.L. Kuzhina Qendrore, kundër rregullave për tenderët jo normalisht të ulët ka theksuar në paramasë se ofertat me çmime jo normalisht të ulëta eliminohen automatikisht nga gara, pa përdorur procedurën “inter-partes”.

K.R.U Prishtina:

- Pavarësisht se nuk kemi të bëjmë me situatë të emergjencës ekstreme, K.R.U Prishtina ka inicuar aktivitetin e prokurimit duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.
- K.R.U. Prishtina ka shkurtuar afatin kohorë për dorëzim të ofertave në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik.
- K.R.U. Prishtina ka ftuar për të marrë pjesë në këtë aktivitetet operatorë ekonomikë të cilat nuk janë të specializuara të kryejnë furnizimet sipas kërkesave të autoritetit.

Rekomandimet

- Autoritetet kontraktuese të mos hartojnë specifika teknike të cilat nuk përmbajnë elemente identifikuese të sakta dhe pamundësojnë realizimin e kontratës sipas specifikave teknike.
- Autoritetet kontraktuese, në përputhje me Ligjin për Prokurimit Publik të hartojnë specifikat teknike dhe të eliminojnë çdo mundësi të kufizimit të konkurrencës duke favorizuar një markë të caktuar.
- Komisionet e pranimit, në kuadër të autoriteteve kontraktuese t'i përmbahen me përpikëri specifikave teknike dhe të mos pranojnë furnizime, shërbime dhe punë që nuk janë në përputhje me specifikat teknike.
- Autoritetet kontraktuese të mos lejojnë variacione nëse paraprakisht nuk është paraparë në dosje të tenderit.
- Autoritetet kontraktuese të paraqesin me saktësi nevojat e veta në paramasë dhe t'i përmbahen paramasës siç është planifikuar.
- Autoritetet kontraktuese në çdo rast kur dyshojnë për tender me çmim jo normalisht të ulët, duhet të zhvillojnë procedurat siç parashihet me rregullat për tenderët jo normalisht të ulët.
- Autoritetet kontraktuese të mos përdorin procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, nëse nuk paraqiten rrethanat që lejojnë përdorimin e kësaj procedure.
- Në çdo procedurë të prokurimit autoritetet kontraktuese të caktojnë afatet për dorëzim të ofertave në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik në mënyrë që operatorët ekonomikë të kenë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertës.
- Nëse ekzistojnë rrethanat për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, autoritetet kontraktuese të sigurohen se po ftojnë në procedurë operatorë ekonomikë që mbulojnë fushën përkatëse.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

